



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

## VENDIM Nr. 182, datë 25.2.2015

### **PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR PËRZGJEDHJEN E RREGULLUESIT KRYESOR (LEAD MANAGER) DHE/OSE HUADHËNËSIT PËR REALIZIMIN E HUAMARRJES ME INSTRUMENTE FINANCIARE NË TREGUN E HUAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, shkronja “ç”, dhe paragrafi i dytë, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Përcaktimin e procedurës që do të ndiqet për procesin e përzgjedhjes së rregulluesit kryesor (Lead Manager) dhe/ose huadhënësit dhe përmbushjen e kësaj procedure për realizimin e huamarrjes me instrumente financiare në tregun e huaj.

2. Bazuar në ligjin vjetor të buxhetit dhe strategjinë e menaxhimit të borxhit publik, me propozim të strukturës përgjegjëse për huamarrjen, ministri i Financave miraton kërkesën për propozim për përzgjedhjen e rregulluesit kryesor (Lead Manager) dhe/ose huadhënësit dhe publikimin e saj.

3. Në kërkesën për propozim duhet të përcaktohen:

- a) qëllimi i financimit;
- b) shuma që synohet të merret hua;
- c) kriteret e përzgjedhjes në përputhje me nenin 6, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”;
- ç) afati i paraqitjes së propozimeve;
- d) data, ora dhe vendi i paraqitjes së propozimeve;

dh) çdo element tjetër i vlerësuar si i nevojshëm.

4. Në rast se përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të propozimeve institucionet e interesuara kërkojnë shtyrjen e këtij afati, titullari i institucionit pas shqyrtimit të kërkesës vendos pranimin ose refuzimin e saj. Vendimi për shtyrjen e afatit publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.

5. Ministria e Financave publikon ftesën për ofertë në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave dhe në dy numra të njëpasnjëshëm në gazetën “Financial Times”.

6. Pas dorëzimit zyrtar në protokollin e Ministrisë së Financave të propozimeve nga institucionet e interesuara, struktura përgjegjëse për huamarrjen në Ministrinë e Financave fillon vlerësimin e tyre. Afati për kryerjen e vlerësimeve është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e përfundimit të afatit për dorëzimin e propozimeve. Në varësi të analizave paraprake të propozimeve, në rast se struktura e huamarrjes e gjykon të arsyeshme, mund t’u kërkojë institucioneve financiare propozuese të dërgojnë sqarime dhe informacion shtesë duke iu caktuar dhe afatin e paraqitjes së tyre. Në këtë rast afati i vlerësimit shtyhet me 5 (pesë) ditë pune nga data e paraqitjes së sqarimeve shtesë.

7. Vlerësimi i propozimeve kryhet nga struktura përgjegjëse për huamarrjen në ministri, duke u bazuar në:

- a) eksperiencën e institucionit në transaksione të ngjashme, prezencën e tyre në tregje dhe kapacitetin për sigurimin e financimit të kërkuar;
- b) risqet e ndryshme që mbart secili prej propozimeve;
- c) koston më të ulët efektive me të gjitha elementet e saj si:
  - i) afati i maturimit;
  - ii) mënyrat e shlyerjes;
  - iii) komisionet, interesi dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në koston e huamarrjes në varësi të kushteve të tregut.

8. Struktura përgjegjëse për huamarrjen në ministri përgatit një raport përmbledhës, ku renditen institucionet pjesëmarrëse në procedurë, të cilin ia dërgon për miratim ministrit.

9. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike Fletorja Zyrtare nga paraqitja e propozimit të bërë nga struktura përgjegjëse e huamarrjes, vendos të miratojë ose të refuzojë shpalljen e fituesit për rregulluesin kryesor (Lead Manager) dhe/ose huadhënësit apo të përsëritë procedurën.

10. Shpallja e fituesit publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.

11. Ankesat e subjekteve ndaj procedurës së zhvilluar i paraqiten, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e njoftimit, ministrit i cili merr vendim brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankesës.

12. Ministri, pas përfundimit të afatit të ankimit, negocion dhe nënshkruan letrën e mandatimit me institucionin fitues, e cila përmban, ndërmjet të tjerash, termat kryesorë të ofrimit të shërbimit.

13. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
Edi Rama